



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. 88/ Prot.  
21

Tiranë, 26/ 22026

URDHËR

Nr. 29/, datë 26/ 22026  
11

“PËR

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË URDHRI NR. 199, DATË 19.12.2021 “PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR  
PËRZGJEDHJEN E KANDIDATËVE PËR KOMISIONER NË INSTITUCIONIN E  
AVOKATIT TË POPULLIT”**

Në zbatim të Ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 2,33, dhe 33/1 të Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar, si dhe të nenit 5 të Rregullores së Brendshme të Punës të Institucionit, miratuar me Urdhri nr.129, datë 17.06.2022:

URDHËROJ:

1. Në Rregulloren bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e Urdhrit nr. 199, datë 19.12.2021 “Për miratimin e Rregullores për Procedurat dhe Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për Komisioner në Institucionin e Avokatit të Popullit”, të bëhen ndryshimet dhe shtesa si më poshtë:
  - a) Në pikën 1 të nenit 10 të Rregullores, shtohet fjala “Shqyrtimi.....”;
  - b) Pika 1 e nenit 11 të Rregullores, ndryshohet si vijon:
    1. *Procesi për shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidaturave për Komisioner në Institucionin e Avokatit të Popullit, organizohet në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile apo mbrojtësit e të drejtave të njeriut, që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave*

*të njeriut e cila lidhet me fushën e veprimtarisë së Seksionit/Seksioneve përkatëse ku do të vlerësohen kandidaturat për Komisioner.*

- c) Në pikën 2 të nenit 12 të Rregullores, shtohen tog fjalësh “.....si dhe të vizionit të tyre për Seksionin/Seksionet përkatëse ku do të vlerësohen, në përputhje me vizionin e paraqitur në dokumentet strategjike të AP”.
- d) Në pikën 3 të nenit 12 të Rregullores, fjalët “.....harton renditjen/listimin e kandidatëve.....” zëvendësohen me fjalët “.....kryen një vlerësim për të gjithë kandidatët.....”.
- e) Në pikën 4 të nenit 12 të Rregullores, fjalët “Në diskutimin e renditjes.....” zëvendësohen me fjalët “Në vlerësimin e kandidatëve.....”.
- f) Pika 1 e nenit 13 e Rregullores, ndryshohet si vijon:  
1. Pas përfundimit të procedurave, Avokati i Popullit, mbështetur në listën e kandidatëve të vlerësuar sipas vlerësimit të Komisionit Ad-Hoc, si dhe vlerësimit të tij individual, për zgjedh katër kandidatë për secilin vend vakant.
- g) Në pikën 2 të nenit 13 të Rregullores, fjalët “.....i vlerësimit të Komisionit Ad-Hoc” zëvendësohen me fjalët “.....i procesit të vlerësimit”.
2. Ngarkohet me zbatimin e këtij Urdhri Sekretari i Përgjithshëm dhe Kabineti i Titullarit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

## AVOKATI I POPULLIT

Endrit SHABANI

*Endrit Shabani*

